

Shkolla e Gjuhës dhe Trashëgimisë Shqiptare

Gjuha Shqipe - Abetare

Mësuesja

Alba Bizhoti

Email

ShkollaShqipeBoston@gmail.com

Vendi dhe Orari

UMass Boston Ndërtesa 6
E Dielë 10am-12pm

Përshkrim

Programi i klases së Abetares, si vazhdimësi e klases parashkollore, është i fokusuar në përvetësimin hap pas hapi të njohjes së fëmijëve me shkronjat e alfabetit shqip, në aftësimin e tyre në shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe për nivelin e klases së parë, si edhe në zhvillimin e të folurit dhe të kuptuarit në përgjithësi të gjuhës shqipe. Nxënësit janë të moshës 5-8 vjeç.

Qëllimi

Mësimdhënia e gjuhës shqipe zhvillohet në një kontekst global dhe duke lidhur elementin gjuhësor me atë kulturor shqiptar.

Programi i klases së Abetares është zhvilluar në mënyre të tillë që t'i njohim fëmijët me gjuhën dhe kulturën shqiptare, duke u dhënë atyre mundësinë të përmirësojnë komunikimin në shqip me prindërit, familjarët dhe pjesëtarët e tjerë në komunitet.

Duke krijuar në moshë të re një lidhje me gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare, ata mësojnë dhe formojnë një pjesë të identitetit të tyre si shqiptaro-amerikane.

Metoda

Fëmijëve u krijohet mundësia të ndihen të lirshëm dhe në klasë krijohet një mjedis i përshtatshëm mësimor. Për shkak të natyrës fonetike të gjuhës shqipe, mësimi i saj bëhet më i lehtë duke qënë se simboli i një shkronjë korespondon vetëm me një tingull dhe anasjelltas.

Qëllimet mësimore arrihen nëpërmjet:

- Mësimi të shkronjave duke i shkruar, dëgjuar dhe shqiptuar
- Mësimi të fjalëve duke i lexuar dhe shkruar
- Zhvillimit të të shprehurit në gjuhën e folur shqipe:
 - Duke formuar fjali të thjeshta



Shkolla Shqipe

B O S T O N

- Duke iu përgjigjur pyetjeve dhe përshkruar aktivitete të jetës së përditshme
 - Duke mësuar vjersha të shkurtra
- Zhvillimit të dëgjimit në gjuhën shqipe:
 - Duke ndjekur leximin e tregimeve
 - Udhëzimet e thjeshta të lojërave interaktive
 - Duke bashkëbiseduar me shokët e klasës